

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikafloor®-100 Level

PËRBËRËS ME BAZË ÇIMENTOJE DHE I MODIFIKUAR ME POLIMERE PËR NIVELIM DYSHEMEJE PËR 2-10 MM, C25-F6



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Përbërës me çlirime shumë të ulëta, bazë çimentoje, i vetënivelueshëm dhe i përshtatshëm për zona të brendshme. Sikafloor®-100 Level karakterizohet si një përbërës nivelimi me veti të mira aplikimi për ngarkesa mesatare.

### PËRDORIMET

Sikafloor®-100 Level është i përshtatshëm për mbushje, lëvim dhe nivelim të nënshtresave të përshtatshme përpara shtrimit të pllakave qeramike, veshjeve tekstile dhe elastike (vinili, linoleumi) për dyshemetë e zonave të brendshme rezidenciale dhe jo industriale.

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- I papërshkueshëm nga adezivët e dispersionit
- I vetënivelueshëm
- Finiturë e lëmuar
- I përshtatshëm për aplikim me sistemet e ngrohjes nën dysheme
- I pompueshëm
- I përshtatshëm për karriget me rrota të zyrave me trashësi shtrese më të madhe se 2 mm sipas EN 12 529
- I modifikuar me polimere
- Transmetim i ulët tensioni tek nënshtresa

### INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EC 1<sup>PLUS</sup> R: lëshime shumë të ulëta, të rregulluara.

### MIRATIME / STANDARDE

Përbërës me bazë çimentoje për nivelim CT-C25-F6 sipas EN 13813, deklaratë performance 115050401, dhe mbart markën CE.

Përbërës me bazë çimentoje për nivelim sipas EN 13813, klasifikuar A1/A1fl sipas EN 13501-1, deklaratë performance 115050401, e vlerësuar nga laborator i njoftuar 1378, dhe mbart markën CE.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Me bazë çimentoje, i modifikuar me polimere
Ambalazhi	Thes letre 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Gri
Jetëgjatësia	6 muaj nga data e prodhimit.
Kushtet e magazinimit	Thasët e hapur duhet të mbyllën menjëherë dhe të përdoren sa më shpejtë të jetë e mundur. Mos magazinoni nën +5 °C.

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	≥25 N/mm <sup>2</sup> (28 ditë në 23 °C)	(EN 13892-2)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	≥6 N/mm <sup>2</sup> (28 ditë në 23°C)	(EN 13892-2)

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	~ 6 l ujë për thes 25 kg Sikafloor®-100 Level	
Konsumimi	~ 1.5 kg/m <sup>2</sup> /mm	
Trashësia e shtresës	2–10 mm	
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.	
Lagështia relative e ajrit	< 75 %	
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.	
Përgatitja e nënshtresës	<b>Nënshtresa</b>	<b>Prajmer</b>
	Nënshtresa me absorbueshmëri normale si betoni, llaçet e çimentos, llaçet e çimentos me mpiksje të shpejtë	Sikafloor®-01 Primer (1:3) ose Sikafloor®-03 Primer
	Nënshtresa sulfati kalciumi (gipsi)	Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer (1:1)
	Nënshtresa joabsorbuese si ato të lyera me prajmer dhe me mbetje të vjetra adezivësh rezistentë ndaj ujit	Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer

Koha e punueshmërisë	~ 30 min. në +20 °C.
----------------------	----------------------

Koha e pritjes / mbiveshja	Sikafloor®-100 Level mund të mbulohet me moketë dhe dysheme elastike si:	
	<b>Trashësia e shtresës</b>	<b>Koha e pritjes</b>
	≤ 3 mm	~24 orë
	≤ 5 mm	~48 orë
≤ 10 mm	~72 orë	

Të gjitha vlerat jepen me përafërsi dhe janë subjekt i ndryshimeve klimaterike. Vlerat jepen në 20°C dhe 65 % lagështi relative, temperaturë nënshtrese +15°C.

Kur të mbuloni Sikafloor®-100 Level sigurohuni gjithnjë se përmbajtja e lagështisë ka arritur në vlerën e dëshiruar që kërkon produkti me të cilin do të vishet (mbulohet), pasi koha e pritjes do të ndikohet nga trashësia e aplikimit dhe lagështia e mjedisit. (Referohuni në skedën teknike të produktit me të cilin do të bëhet veshja).

Produkti i aplikuar gati për përdorim	Gati për qarkullim këmbësorësh pas ~ 3 orësh.
---------------------------------------	---

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtresa të përshtatshme: betoni, çimentoja, llaçet e çimentos me ngurtësim të shpejtë, llaçet me bazë gipsi.

Nevojat e nënshtresës:

- Rezistencë e mjaftueshme, kapacitet për bartje ngarkese, qëndrueshmëri përmasash dhe thatësi e përhershme.
- Duhet të jetë e qëndrueshme dhe e pastër, pa kontaminues, si p.sh. pluhur, ndotje, vaj, graso dhe grimca të lira.

- Shtresat ndarëse, korja e çimentos dhe shtresa të ngjashme duhet të hiqen me mjete të përshtatshme, si smerilizimi, fërkimi, pastrimi me rrymë abrazive, frezim ose pastrim të plotë.
- Shtresat e vjetra, të lira dhe të dobëta të nivelimit duhet të hiqen mekanikisht.
- Shtresat e adezivëve të tretshëm në ujë, p.sh. adezivë sulfatesh, duhet të hiqen mekanikisht. Mbetjet e adezivëve duhet të lyhen me prajmerin Sikafloor®-155WN/-156/160/161 ose Sika® Primer MB. Nëse ky prajmer nuk spërkatet plotësisht me rërë kuarci, Sikafloor®-02 Primer duhet të përdoret përpara aplikimit të Sikafloor®-100 Level.
- Adezivët e vjetër rezistentë ndaj ujit duhet të hiqen

- mekanikisht sa më shumë të jetë e mundur.
- Produktet për trajtimin e sipërfaqes apo zonat e shkrifëta të nënshtresës duhet të hiqen mekanikisht dhe mbushja e vrimave dhe hapësirave duhet të bëhet me Sika®Patch-5.
  - Prajmerat akrilikë me një përbërës si Sikafloor®-01 Primer, Sika®-02 Primer, Sika®-03 Primer rekomandohen për të përfutur një sipërfaqe pa pore dhe me ndërkapje shumë të mirë. Ju lutemi referohuni në skedat teknike të produkteve përkatëse.
  - Mos aplikoni mbi nënshtresa me lagështi në rritje. Nëse do të ketë rast të lagështisë në rritje, duhet të përdoret një barrierë e përshtatshme lagështie sipas standardeve kombëtare në fuqi.
  - Në çdo rast duhet të zbatohen standardet përkatëse në fuqi, udhëzimet dhe skedat teknike të produktit.

## PËRZIERJA

Shtoni Sikafloor®-100 Level tek i uji i ftohtë dhe i pastër në një konteiner të pastër dhe përzieni ~ 2 min për një miksturë homogjene. Rekomandohet përdorimi i një përzierësi me shufër rrotulluese. Pas një periudhe të shkurtër maturimi, përzieni përsëri plotësisht.

Shënim: Mos përzieni Sikafloor®-100 Level me çimento apo produkte të tjera me bazë çimentoje.

## APLIKIMI

- Pas përzierjes hidhni përbërësin e nivelimit dhe përhapeni me një mallë të dhembëzuar, krëhër (screed rake) ose nivelues me gjilpëra (pin leveller). Me përdorimin e niveluesit me gjilpëra zakonisht nuk nevojitet ruli me gjemba për të korrigjuar defektet e krijuara nga malla.
- Fugat e skajeve dhe të lëvizjes duhet të sillen në të njëjtin nivel me sipërfaqen e përfunduar dhe duhet të mbrohen nga rrjedhja e përbërësit të nivelimit brenda tyre.
- Në raste të trashësisë më të madhe, kontakti me strukturat vertikale duhet të shmanget duke vendosur në perimetër shirit izolues.
- Punimet e nivelimit duhet të zbatohen në trashësi të mjaftueshme dhe rrafshësi sipërfaqeje siç përcaktohet nga prodhuesi i pllakave apo dyshemeve përfundimtare.
- Kontakti me tubat metalikë që bartin ujë duhet shmangur (p.sh. mbyllja e depërtimeve të tubacioneve), sepse tubat e çelikut posaçërisht të galvanizuar nuk kanë mbrojtje të mjaftueshme ndaj korrodimit.
- Mbroni shtresat niveluese Sikafloor®-100 Level gjatë maturimit nga temperaturat e larta të ambientit, rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe thatësira.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## DOKUMENTA SHITESË

Duhet të respektohen rekomandimet, udhëzimet, Standardet Europiane, rregulloret e zbatueshme dhe Fletët me të Dhënat e Sigurisë, së bashku me rregulloret e njohura arkitekturore dhe inxhinierike.

## KUFIZIME

- Niveloni plotësisht sipërfaqen me trashësi minimale shtrese 5 mm kur do të mbuloni me parket.
- Sipas rregulloreve gjermane, për vendosjen vijuese të mbulimit të dyshemesë, nënshtresat me bazë çimentoje si llaçi dhe betoni kërkohet të kenë përmbajtje lagështie ≤ 2.0 CM-% (për heating screeds ≤ 1.8 CM-%), llaçe sulfati kalciumi (gipsi) ≤ 0.5 CM-% (për heating screeds ≤ 0.3 CM-%).

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

### GISCODE

ZP-1 - produkte çimentoje, me sasi të ulët kromatesh.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-100 Level

Mars 2019, Botimi 02.01

020815030010000151

Sikafloor-100Level-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf